



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:231960
Datë: 13.09.2024
Numri i dokumentit: 06158756

C.nr.220/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË- DEGA NE VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në procedurën kontestimore sipas padisë së paditëses KEP-Trust, dega në Mitrovicë, të cilën e përfaqëson A.A sipas autorizimit, kundër të paditurit N.B, me objekt kontesti për pagimin e borxhit nga marrëveshja mbi kredinë, më datë 13.09.2024, mori këtë

A K T V E N D I M

- I.** KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia C.nr.220/2019, e datës 24.05.2019, e paditëses KEP-Trust, kundër të paditurit N.B për pagimin e borxhit nga marrëveshja mbi kredinë.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja KEP-Trust, me datë 24.05.2019, ka paraqitur në këtë gjykatë padinë ndaj të paditurit N.B për pagimin e borxhit nga marrëveshja mbi kredinë.

Gjykata lidhur me këtë çështje e ka caktuar seancën përgatitore me datë 06.08.2024, në të cilën ka marrë pjesë përfaqësuesi i paditëses A.A, kurse ka munguar i padituri sepse i njëjti ka qenë i panjohur në adresën e theksuar në padi. Gjykata në atë seancë ka marrë aktvendim me të cilin e ka detyruar paditësen t'ia dorëzoj gjykatës adresën e saktë të të paditurit në mënyrë që i njëjti të ftohet me rregull në këtë proces gjyqësor.

Paditësja me datë 12.08.2024 ka dorëzuar në gjykatë parashtrësën për sigurimin e adresës së saktë të të paditurit. Pas pranimit të adresës së saktë të të paditurit, gjykata ka caktuar seancën përgatitore me datë 11.09.2024 në orën 13:30, në të cilën seancë prezent ka qenë vetëm i padituri ndërsa ka munguar paditësja, e cila është njoftuar për seancë përmes thirrjes së rregullt, ashtu që sipas flet kthesës së pranuar në gjykatë me datë 02.09.2024, paditësja më datë 28.08.2024, e ka pranuar në mënyrë të rregullt ftesën për seancën e datës 11.09.2024, mirëpo mungesën për këtë seancë nuk e ka arsyetuar.

Gjykata ka pritur për 15 minuta për përfaqësuesin e paditëses mirëpo kjo pritje rezultojë e pasuksesshme, kurse pas fillimit të seancës, i padituri kërkoj që kërkesëpadia e paditëses të konsiderohet e tërhequr.

Andaj, duke u bazuar në nenin 409, par 1 të Ligjit nr. 03/L-006 të Procedurës Kontestimore sipas të cilit thuhet se *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahej”*, gjykata ka marrë vendim si në dispozitivin I, të këtij aktvendimi, me të cilin vendim padia e paditëses është konsideruar e tërhequr.

Gjykata vendosi si në dispozitivin II, të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:231960, CN.nr.220/2019, me datë 13.09.2024**

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë e përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.